

Direktiva 2008/68/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 24 shtator 2008, “Mbi transportin tokësor të mallrave të rrezikshme”

Kjo Tabelë e Përputhshmërisë vlerëson shkallën e përafrimit të projektligjit “Për transportin e mallrave të rrezikshme” me Direktivën 2008/68/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 24 shtator 2008, “Mbi transportin tokësor të mallrave të rrezikshme”, siç është ndryshuar. Projektligji rregullon transportin rrugor dhe hekurudhor të mallrave të rrezikshme në Republikën e Shqipërisë dhe zbaton ADR-në dhe RID-in nëpërmjet referimit.

Projektligji nuk rregullon transportin e mallrave të rrezikshme në rrugë ujore të brendshme. Kjo mënyrë transporti përjashtohet shprehimisht dhe moszbatimi i kërkesave që lidhen me ADN-në trajtohet në përputhje me nenin 1(3) të Direktivës 2008/68/KE.

Dispozitat kryesore të Direktivës që lidhen me fushën e zbatimit, përkufizimet, rregullat e përgjithshme, transportin drejt dhe nga shtetet e treta, kufizimet për arsye sigurie, përjashtimet, autorizimet individuale, dispozitat kalimtare, referimet ndaj ADR-së dhe RID-it, si dhe komunikimin me Komisionin Evropian pas anëtarësimit, janë pasqyruar në projektligj.

Në bazë të këtij vlerësimi, shkalla e përgjithshme e përafrimit të projektligjit me Direktivën 2008/68/KE vlerësohet si përafrim i plotë për dispozitat e zbatueshme për Shqipërinë.

Projektligji parashikon një kuadër ligjor të plotë për transportin rrugor dhe hekurudhor të mallrave të rrezikshme në Republikën e Shqipërisë. Ai transponon dispozitat e zbatueshme të Direktivës 2008/68/KE kryesisht nëpërmjet legjislacionit parësor dhe mbështetet në referimin ndaj ADR-së dhe RID-it për rregullat teknike të zbatueshme.

Fushat kryesore të përafruara plotësisht përfshijnë fushën e zbatimit për transportin rrugor dhe hekurudhor, përjashtimin e transportit me mjete ose vagonë nën përgjegjësinë e Forcave të Armatosura, përjashtimin e transportit të kryer tërësisht brenda një zone të mbyllur, përkufizimet e ADR-së, RID-it, mjetit rrugor dhe vagonit, rregullin e përgjithshëm sipas të cilit mallrat e rrezikshme mund të transportohen vetëm në kushtet e përcaktuara në ADR ose RID, transportin drejt dhe nga shtetet e tjera, kufizimet për arsye sigurie, përdorimin e gjuhëve për operationet e transportit të brendshëm, përjashtimet, autorizimet individuale dhe komunikimin me Komisionin Evropian pas anëtarësimit.

DIREKTIVA 2008/68/KE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, datë 24 shtator 2008, “Mbi transportin tokësor të mallrave të rrezikshme” siç është ndryshuar deri me Vendimin Zbatues (BE) 2026/1041 të Komisionit, datë 5 maj 2026. (Celex L 260, 30.9.2008, f. 13)		Legjislacioni shqiptar 1.1 Projektligji “Për transportin e mallrave të rrezikshme” Shkalla e përgjithshme e përafrimit të projektaktit (një nga alternativat e mëposhtme) F – Plotësisht e harmonizuar P – Pjesërisht e harmonizuar N – Pa Harmonizuar n/a – jo relevante për përafrim Shkalla e përputhshmërisë: F (e plotë)				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime
Neni 1 Fusha e zbatimit	1. Kjo direktivë zbatohet për transportin e mallrave të rrezikshme me rrugë, me hekurudhë ose në rrugë ujore të brendshme, brenda ose ndërmjet shteteve anëtare, duke përfshirë veprimtaritë e ngarkimit dhe shkarkimit, transferimin drejt ose nga një mënyrë tjetër transporti.	1.1	3.1; 3.2	3.1 Ky ligj zbatohet për transportin rrugor dhe hekurudhor të mallrave të rrezikshme: a) brenda territorit të Republikës së Shqipërisë; b) nga territori i një shteti tjetër drejt territorit të Republikës së Shqipërisë; c) nga territori i Republikës së Shqipërisë drejt territorit të një shteti tjetër; ç) në transit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë. 3.2 Ky ligj zbatohet edhe për veprimtaritë e lidhura drejtpërdrejt me transportin e mallrave të rrezikshme, përfshirë ngarkimin, shkarkimin, transferimin nga ose drejt një mënyre tjetër transporti dhe ndalesat e nevojshme për shkak të rrethanave të transportit, për aq sa këto	F	Projektligji transpozoi dispozitën për transportin rrugor dhe hekurudhor të mallrave të rrezikshme, duke përfshirë transportin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nga dhe drejt territorit të Republikës së Shqipërisë, transitin, si dhe veprimtaritë e lidhura drejtpërdrejt me këtë transport, përfshirë ngarkimin, shkarkimin, transferimin nga ose drejt një mënyre tjetër transporti dhe ndalesat e nevojshme gjatë transportit. Çështja e transportit në rrugë ujore të brendshme trajtohet veçmas në kuadër të nenit 1(3) të Direktivës.

				veprimtari lidhen me transportin rrugor ose hekurudhor të mallrave të rrezikshme.		
1, paragrafi i dytë	Ajo nuk zbatohet për transportin e mallrave të rrezikshme:	1.1	3.3	3.3 Ky ligj nuk zbatohet për transportin e mallrave të rrezikshme:	F	
1 (a)	(a) me mjete, vagonë ose anije që u përkasin ose janë nën përgjegjësinë e forcave të armatosura;	1.1	3.3.a	a) me mjete rrugore ose vagonë që u përkasin ose janë nën përgjegjësinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe forcave të armatosura të shteteve të tjera, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare në fuqi;	F	Projektligji transpozon përjashtimin e parashikuar për transportin me mjete rrugore ose vagonë që u përkasin ose janë nën përgjegjësinë e Forcave të Armatosura. Pjesa e Direktivës që i referohet anijeve nuk është e zbatueshme për këtë projektligj, pasi transporti në rrugë ujore të brendshme trajtohet veçmas në kuadër të nenit 1(3).
1 (b)	(b) me anije detare në rrugë ujore detare që përbëjnë pjesë të rrugëve ujore të brendshme;	N/A	N/A	N/A	N/A	Projektligji nuk rregullon transportin e mallrave të rrezikshme në rrugë ujore të brendshme; kjo mënyrë transporti përjashtohet shprehimisht nga fusha e zbatimit sipas nenit 3, pika 4. Çështja e moszbatimit të aneksit III/ADN-së trajtohet veçmas në kuadër të nenit 1(3) të Direktivës.
1 (c)	(c) me tragete që kalojnë vetëm një rrugë ujore të brendshme ose port; ose	N/A	N/A	N/A	N/A	Si më sipër.
1 (d)	(d) i kryer tërësisht brenda perimetrit të një zone të mbyllur.	1.1	3.3.b	b) tërësisht brenda perimetrit të një zone të mbyllur.	F	
1 (2)	2. Aneksi II, seksioni II.1, nuk zbatohet për shtetet anëtare që nuk kanë sistem hekurudhor, për aq kohë sa në territorin e tyre nuk është krijuar një sistem i tillë.	N/A	N/A	N/A	N/A	Dispozita nuk është e zbatueshme, pasi Shqipëria ka sistem hekurudhor.

1 (3)	3. Brenda një viti nga hyrja në fuqi e kësaj direktive, shtetet anëtare mund të vendosin të mos zbatojnë aneksin III, seksioni III.1, për një nga arsyet e mëposhtme:	1.1	3.4; 67.2.a	4. Në Republikën e Shqipërisë nuk lejohet transporti i mallrave të rrezikshme në rrugë ujore të brendshme. 67.2. Ministria përgjegjëse për transportin njofton Komisionin Evropian, duke paraqitur edhe arsyetimin përkatës, për: a) moszbatimin e kërkesave për transportin e mallrave të rrezikshme në rrugë ujore të brendshme, në lidhje me nenin 3, pika 4, të këtij ligji, për shkaqet e mëposhtme:	F	Projektligji nuk përfshin zbatimin e ADN-së dhe parashikon se transporti i mallrave të rrezikshme në rrugë ujore të brendshme nuk lejohet në Republikën e Shqipërisë. Moszbatimi i kërkesave për transportin e mallrave të rrezikshme në rrugë ujore të brendshme lidhet me nenin 3, pika 4, dhe njoftohet sipas nenit 67, pika 2, shkronja “a”, pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian.
1 (3)	(a) nuk kanë rrugë ujore të brendshme;	N/A	N/A	N/A	N/A	Shkaku i përjashtimit nuk bazohet në mungesën e rrugëve ujore të brendshme.
1 (3)	(b) rrugët e tyre ujore të brendshme nuk janë të lidhura, nëpërmjet rrugëve ujore të brendshme, me rrugët ujore të shteteve të tjera anëtare; ose	1.1	67.2.a.i	i) rrugët ujore të brendshme të Republikës së Shqipërisë nuk janë të lidhura, nëpërmjet rrugëve ujore të brendshme, me rrugët ujore të brendshme të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian; ose	F	Projektligji parashikon, si shkak për moszbatimin e kërkesave për transportin e mallrave të rrezikshme në rrugë ujore të brendshme, faktin se rrugët ujore të brendshme të Republikës së Shqipërisë nuk janë të lidhura, nëpërmjet rrugëve ujore të brendshme, me rrugët ujore të brendshme të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.
1 (3)	(c) në rrugët e tyre ujore të brendshme nuk transportohen mallra të rrezikshme.	1.1	67.2.a.ii	ii) në rrugët ujore të brendshme të Republikës së Shqipërisë nuk kryhet transport i mallrave të rrezikshme;	F	Projektligji parashikon, si shkak shtesë për moszbatimin e kërkesave për transportin e mallrave të rrezikshme në rrugë ujore të brendshme, faktin se në këto rrugë ujore nuk kryhet transport i mallrave të rrezikshme.

1 (3)	Nëse një shtet anëtar vendos të mos zbatojë dispozitat e aneksit III, seksioni III.1, ai ia njofton këtë vendim Komisionit, i cili informon shtetet e tjera anëtare.	1.1	67.1; 67.2.a	67.1. Pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ministria përgjegjëse për transportin kryen komunikimin zyrtar me Komisionin Evropian në rastet kur ky ligj ose legjislacioni i Bashkimit Evropian kërkon njoftim, arsyetim, raportim, kërkesë për autorizim ose kërkesë për zgjatje të autorizimit. 67.2. Ministria përgjegjëse për transportin njofton Komisionin Evropian, duke paraqitur edhe arsyetimin përkatës, për: a) moszbatimin e kërkesave për transportin e mallrave të rrezikshme në rrugë ujore të brendshme, në lidhje me nenin 3, pika 4, të këtij ligji, për shkaqet e mëposhtme:	F	Projektligji parashikon që, pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian, ministria përgjegjëse për transportin njofton Komisionin Evropian dhe paraqet arsyetimin përkatës për moszbatimin e kërkesave për transportin e mallrave të rrezikshme në rrugë ujore të brendshme. Pjesa që lidhet me informimin e shteteve të tjera anëtare është detyrim i Komisionit Evropian dhe nuk kërkon transpozim në projektligj.
1 (4)	4. Shtetet anëtare mund të përcaktojnë kërkesa të posaçme sigurie për transportin kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme brenda territorit të tyre, për sa u përket:	N/A	N/A	N/A	N/A	Projektligji nuk krijon një regjim të përgjithshëm të kërkesave të posaçme të sigurisë sipas nenit 1(4) të Direktivës. Kufizimet dhe ndalimet e posaçme për arsye sigurie trajtohen në kuadër të nenit 5(1) të Direktivës dhe nenit 46 të projektligjit.
1 (4)	(a) transportit të mallrave të rrezikshme me mjete, vagonë ose anije të rrugëve ujore të brendshme që nuk mbulohen nga kjo direktivë;	N/A	N/A	N/A	N/A	Projektligji nuk e përdor këtë mundësi dhe nuk krijon rregullim të posaçëm për kategori mjetesesh ose vagonësh jashtë fushës së ligjit. Transporti në rrugë ujore të brendshme trajtohet veçmas në kuadër të nenit 1(3) të Direktivës.
1 (4)	(b) kur justifikohet, përdorimit të itinerareve të përcaktuara, duke përfshirë përdorimin e mënyrave të përcaktuara të transportit;	N/A	N/A	N/A	N/A	Projektligji nuk krijon një regjim të përgjithshëm për itineraret ose mënyrat e

						përcaktuara të transportit sipas nenit 1(4)(b) të Direktivës. Kufizimet ose ndalimet e posaçme për arsye sigurie trajtohen në kuadër të nenit 5(1) të Direktivës dhe nenit 46 të projektligjit.
1 (4)	(c) rregullave të posaçme për transportin e mallrave të rrezikshme në trenat e pasagjerëve.	N/A	N/A	N/A	N/A	Projektligji nuk përcakton rregulla të posaçme kombëtare për transportin e mallrave të rrezikshme në trenat e pasagjerëve. Për transportin hekurudhor zbatohen kërkesat e RID-it.
1 (4)	Ato informojnë Komisionin për këto dispozita dhe arsyetimet e tyre.	N/A	N/A	N/A	N/A	
1 (4)	Komisioni informon përkatësisht shtetet e tjera anëtare.	N/A	N/A	N/A	N/A	
1 (5)	5. Shtetet anëtare mund të rregullojnë ose ndalojnë, vetëm për arsye të tjera nga siguria gjatë transportit, transportin e mallrave të rrezikshme brenda territorit të tyre.	N/A	N/A	N/A	N/A	Projektligji nuk e përdor dispozitën fakultative të nenit 1(5) të Direktivës dhe nuk përcakton rregulla ose ndalime për transportin e mallrave të rrezikshme për arsye të tjera nga siguria gjatë transportit. Kufizimet dhe ndalimet e posaçme të parashikuara në projektligj lidhen me arsye sigurie dhe trajtohen në kuadër të nenit 5(1) të Direktivës.
Neni 2 Përkufizime	Përkufizime Për qëllimet e kësaj direktive:	1.1	4	Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:	F	
2 (1)	1. “ADR” është Marrëveshja Evropiane për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme, e lidhur në Gjenevë, më 30 shtator 1957, siç është ndryshuar;	1.1	4.1	1. “ADR” është Marrëveshja Evropiane për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme, e lidhur në	F	

				Gjenevë, më 30 shtator 1957, së bashku me anekset A dhe B të saj, siç është ndryshuar, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr. 9272, datë 16.9.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen Evropiane për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (ADR)”.		
2 (2)	2. “RID” është Rregullorja për Transportin Ndërkombëtar Hekurudhor të Mallrave të Rrezikshme, që paraqitet si Shtojca C e Konventës për Transportin Ndërkombëtar Hekurudhor (COTIF), e lidhur në Vilnius, më 3 qershor 1999, siç është ndryshuar;	1.1	4.13	13. “RID” është Rregullorja për transportin ndërkombëtar hekurudhor të mallrave të rrezikshme, që përbën Shtojcën C të Konventës për Transportin Ndërkombëtar Hekurudhor (COTIF), e lidhur në Vilnius, më 3 qershor 1999, siç është ndryshuar, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar nëpërmjet ligjit nr. 8638, datë 13.7.2000, “Për aderimin në Protokollin e Vilniusit të 3 qershorit 1999, që përmban modifikimin e Konventës për Transportet Ndërkombëtare Hekurudhore (COTIF), të 9 majit 1980”.	F	
2 (3)	3. “ADN” është Marrëveshja Evropiane për Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme në Rrugë Ujore të Brendshme, e lidhur në Gjenevë, më 26 maj 2000, siç është ndryshuar;	N/A	N/A	N/A	N/A	Projektligji nuk e përkufizon ADN-në, pasi nuk përfshin zbatimin e saj dhe nuk lejon transportin e mallrave të rrezikshme në rrugë ujore të brendshme. Kjo çështje trajtohet në nenin 3, pika 4, të projektligjit.
2 (4)	4. “mjet” është çdo mjet motorik i destinuar për përdorim në rrugë, që ka të paktën katër rrota dhe shpejtësi maksimale të projektuar mbi 25 km/orë, si dhe çdo rimorkio, me përjashtim të mjeteve që lëvizin mbi shina, makinerive të lëvizshme dhe traktorëve bujqësorë e pyjorë	1.1	4.9	9. “Mjet rrugor” është çdo mjet motorik i destinuar për përdorim në rrugë, që ka të paktën katër rrota dhe shpejtësi maksimale të projektuar mbi 25 km/orë, si dhe çdo rimorkio, me përjashtim të mjeteve që lëvizin mbi shina, makinerive të lëvizshme	F	

	që, gjatë transportit të mallrave të rrezikshme, nuk lëvizin me shpejtësi mbi 40 km/orë;			dhe traktorëve bujqësorë ose pyjorë që, gjatë transportit të mallrave të rrezikshme, nuk lëvizin me shpejtësi mbi 40 km/orë.		
2 (5)	5. “vagon” është çdo mjet hekurudhor pa mjetet e veta të lëvizjes, që lëviz mbi rrotat e veta në shina hekurudhore dhe përdoret për transportin e mallrave;	1.1	4.16	16. “Vagon” është çdo mjet hekurudhor pa fuqi vetëlëvizëse, që lëviz mbi rrotat e veta në shina hekurudhore dhe përdoret për transportin e mallrave.	F	
2 (6)	6. “anije” është çdo anije e rrugëve ujore të brendshme ose anije detare.	N/A	N/A	N/A	N/A	Projektligji nuk e përkufizon termin “anije”, pasi nuk rregullon transportin e mallrave të rrezikshme me anije dhe nuk lejon transportin e mallrave të rrezikshme në rrugë ujore të brendshme.
Neni 3 Dispozita të përgjithshme	1. Pa cenuar nenin 6, mallrat e rrezikshme nuk transportohen për aq sa transporti i tyre ndalohet nga aneksi I, seksioni I.1, aneksi II, seksioni II.1, ose aneksi III, seksioni III.1.	1.1	5.1; 5.2	1. Transporti i mallrave të rrezikshme me rrugë ose me hekurudhë lejohet vetëm kur kryhet në kushtet e përcaktuara përkatësisht në ADR, së bashku me anekset A dhe B të saj, ose në RID, si Shtojca C e Konventës për Transportin Ndërkombëtar Hekurudhor (COTIF), pa cenuar rregullat e përgjithshme për hyrjen në treg dhe rregullat e përgjithshme të zbatueshme për transportin e mallrave. 2. Në përjashtim nga pika 1 e këtij neni dhe vetëm në rastet e parashikuara në nenin 47 të këtij ligji, mund të autorizohet kryerja e një operacioni të caktuar transporti të mallrave të rrezikshme që është i ndaluar sipas ADR-së ose RID-it, ose kryerja e tij në kushte të ndryshme nga ato të përcaktuara në ADR ose RID.	F	Projektligji parashikon se transporti i mallrave të rrezikshme mund të kryhet vetëm kur lejohet sipas ADR-së ose RID-it dhe se, vetëm në rastet e parashikuara në nenin 47, mund të autorizohet një operacion i caktuar transporti i ndaluar sipas ADR-së ose RID-it, ose kryerja e tij në kushte të ndryshme. Referimi ndaj aneksit III, seksioni III.1, nuk pasqyrohet në këtë dispozitë, pasi transporti në rrugë ujore të brendshme përjashtohet nga fusha e projektligjit dhe trajtohet veçmas në kuadër të nenit 1(3) të Direktivës.

3 (2)	2. Pa cenuar rregullat e përgjithshme për hyrjen në treg ose rregullat përgjithësisht të zbatueshme për transportin e mallrave, transporti i mallrave të rrezikshme lejohet me kusht që të përmbushen kushtet e përcaktuara në aneksin I, seksioni I.1, aneksin II, seksioni II.1, dhe aneksin III, seksioni III.1.	1.1	5.1	1. Transporti i mallrave të rrezikshme me rrugë ose me hekurudhë lejohet vetëm kur kryhet në kushtet e përcaktuara përkatësisht në ADR, së bashku me anekset A dhe B të saj, ose në RID, si Shtojca C e Konventës për Transportin Ndërkombëtar Hekurudhor (COTIF), pa cenuar rregullat e përgjithshme për hyrjen në treg dhe rregullat e përgjithshme të zbatueshme për transportin e mallrave.	F	Projektligji parashikon se transporti rrugor ose hekurudhor i mallrave të rrezikshme lejohet vetëm kur kryhet në përputhje me kushtet e përcaktuara në ADR ose RID. Formulimi ruan gjithashtu pjesën e Direktivës për moscenimin e rregullave të përgjithshme për hyrjen në treg dhe të rregullave të përgjithshme të zbatueshme për transportin e mallrave. Referimi ndaj aneksit III, seksioni III.1, nuk pasqyrohet, pasi transporti në rrugë ujore të brendshme është jashtë fushës së projektligjit.
Neni 4 Shtetet e treta	Transporti i mallrave të rrezikshme ndërmjet shteteve anëtare dhe shteteve të treta lejohet për aq sa përmbush kërkesat e ADR-së, RID-it ose ADN-së, përveç kur në anekse parashikohet ndryshe.	1.1	5.3	3. Transporti i mallrave të rrezikshme nga ose drejt një shteti tjetër lejohet kur përputhet me kërkesat përkatëse të ADR-së ose RID-it, përveç kur në ADR ose RID parashikohet ndryshe.	F	Projektligji zbatohet për transportin e mallrave të rrezikshme nga Republika e Shqipërisë drejt një shteti tjetër dhe nga një shtet tjetër drejt Republikës së Shqipërisë. Në këto raste, transporti lejohet kur përmbush kërkesat përkatëse të ADR-së ose RID-it, përveç kur në ADR ose RID parashikohet ndryshe. Referimi ndaj ADN-së nuk pasqyrohet, pasi transporti në rrugë ujore të brendshme është jashtë fushës së projektligjit.
Neni 5 Kufizim et për arsye të sigurisë së	1. Për arsye të sigurisë së transportit, shtetet anëtare mund të zbatojnë dispozita më të rrepta, me përjashtim të kërkesave të ndërtimit, për transportin kombëtar të mallrave të rrezikshme me mjete, vagonë dhe anije të rrugëve ujore të	1.1	46.1–46.4	1. Për arsye të sigurisë publike, mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të njerëzve, mbrojtjes së mjedisit, sigurisë rrugore, sigurisë hekurudhore, mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese, sigurisë bërthamore ose mbrojtjes civile, autoriteti që lëshon	F	Projektligji përdor mundësinë e parashikuar në nenin 5(1) të Direktivës, duke lejuar kufizime ose ndalime të posaçme për arsye të sigurisë së transportit. Këto kufizime mund të lidhen

transportit	brendshme, të regjistruara ose të vendosura në qarkullim brenda territorit të tyre.			autorizimin sipas nenit 41 të këtij ligji, Policia Rrugore ose Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore, sipas rastit dhe fushës së përgjegjësisë, mund të vendosin kufizime ose ndalime të posaçme për kryerjen e transportit të mallrave të rrezikshme. 2. Kufizimet ose ndalimet sipas pikës 1 të këtij neni mund të lidhen me itinerarin, kohën e transportit, vendin e ndalimit ose parkimit, kalimin në zona të caktuara, përdorimin e infrastrukturës, shoqërimin, njoftimin paraprak ose masa të tjera të nevojshme sigurie. 3. Kufizimet ose ndalimet duhet të jenë të arsyetuara, proporcionale me rrezikun dhe të kufizuara në masën dhe kohën e nevojshme për shmangien ose uljen e rrezikut. 4. Kufizimet ose ndalimet sipas këtij neni kanë karakter operativ ose organizativ dhe nuk ndryshojnë kërkesat teknike të ADR-së ose RID-it për klasifikimin, ambalazhimin, shënimin, etiketimin, cisternat, mjetet ose vagonët, përveç kur kjo lejohet shprehimisht nga ADR-ja ose RID-i.		me masa operative ose organizative, si itinerari, koha e transportit, ndalimi ose parkimi, kalimi në zona të caktuara, përdorimi i infrastrukturës, shoqërimi, njoftimi paraprak ose masa të tjera të nevojshme sigurie. Projektligji parashikon shprehimisht se këto masa nuk ndryshojnë kërkesat teknike të ADR-së ose RID-it për klasifikimin, ambalazhimin, shënimin, etiketimin, cisternat, mjetet ose vagonët, përveç kur kjo lejohet shprehimisht nga ADR-ja ose RID-i. Transporti në rrugë ujore të brendshme nuk pasqyrohet, pasi nuk lejohet sipas projektligjit.
5 (2)	2. Nëse, në rast aksidenti ose incidenti brenda territorit të tij, një shtet anëtar vlerëson se dispozitat e zbatueshme të sigurisë janë të pamjaftueshme për të kufizuar rreziqet e përfshira në operacionet e transportit dhe ekziston nevojë urgjente për veprim, ai shtet anëtar, në fazën e planifikimit, njofton Komisionin për masat që propozon të marrë.	1.1	67.1; 67.2.c	67.1 67.1. Pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ministria përgjegjëse për transportin kryen komunikimin zyrtar me Komisionin Evropian në rastet kur ky ligj ose legjislacioni i Bashkimit Evropian kërkon njoftim, arsyetim, raportim, kërkesë për autorizim ose kërkesë për zgjatje të autorizimit. 67.2. Ministria përgjegjëse për transportin njofton Komisionin Evropian, duke paraqitur edhe arsyetimin përkatës, për:	F	Projektligji parashikon që, pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian, ministria përgjegjëse për transportin njofton Komisionin Evropian për masat që propozohen të merren, në fazën e planifikimit, pas një aksidenti ose incidenti në territorin e Republikës së Shqipërisë, kur dispozitat e zbatueshme të sigurisë sipas ligjit, ADR-së ose RID-it

				c) masat që propozohen të merren, në fazën e planifikimit, pas një aksidenti ose incidenti në territorin e Republikës së Shqipërisë, kur dispozitat e sigurisë të zbatueshme sipas këtij ligji, ADR-së ose RID-it vlerësohen të pamjaftueshme për të kufizuar rreziqet e përfshira në operacionet e transportit dhe ekziston nevojë urgjente për veprim.		vlerësohen të pamjaftueshme për të kufizuar rreziqet e përfshira në operacionet e transportit dhe ekziston nevojë urgjente për veprim.
5 (2), paragrafi i dytë	Duke vepruar në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 9(2), Komisioni vendos nëse autorizon zbatimin e masave në fjalë dhe kohëzgjatjen e këtij autorizimi.	1.1	67.4	67.4. Masat e propozuara sipas pikës 2, shkronja “c”, të këtij neni dhe përjashtimet me karakter të përgjithshëm sipas pikës 3 të këtij neni zbatohen vetëm pas autorizimit nga Komisioni Evropian dhe për afatin e përcaktuar në vendimin përkatës të autorizimit. Përjashtimet me karakter të përgjithshëm sipas pikës 3 të këtij neni nuk mund të autorizohen për një afat më të gjatë se gjashtë vjet nga data e autorizimit dhe zbatohen pa diskriminim.	N/A	Projektligji parashikon se masat e propozuara pas një aksidenti ose incidenti zbatohen vetëm pas autorizimit nga Komisioni Evropian dhe për afatin e përcaktuar në vendimin përkatës të autorizimit.
Neni 6 Përjashtimet	1. Shtetet anëtare mund të autorizojnë përdorimin e gjuhëve të tjera nga ato të parashikuara në anekse për operacionet e transportit të kryera brenda territoreve të tyre.	1.1	5.4	4. Për operacionet e transportit të mallrave të rrezikshme që kryhen tërësisht brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, dokumentet dhe informacionet që shoqërojnë transportin, sipas ADR-së ose RID-it, mund të jenë edhe në gjuhën angleze. Autoriteti kompetent mund të kërkojë përkthimin në gjuhën shqipe kur kjo është e nevojshme për kontrollin, verifikimin ose sigurinë e transportit.	F	Projektligji lejon që, për operacionet e transportit të mallrave të rrezikshme të kryera tërësisht brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, dokumentet dhe informacionet që shoqërojnë transportin sipas ADR-së ose RID-it të mund të jenë edhe në gjuhën angleze.
6 (2) (a)	2. (a) Me kusht që siguria të mos cenohet, shtetet anëtare mund të kërkojnë përjashtime nga aneksi I, seksioni I.1, aneksi II, seksioni II.1, dhe aneksi III, seksioni III.1, për transportin brenda territoreve të tyre të sasive	1.1	47.10.a	10. Përjashtimet me karakter të përgjithshëm nga ADR-ja ose RID-i, për transportin e mallrave të rrezikshme brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, mund të kërkojnë vetëm kur siguria e transportit	F	Projektligji parashikon mundësinë për të kërkuar përjashtime me karakter të përgjithshëm për transportin e sasive të vogla të mallrave të

	të vogla të mallrave të caktuara të rrezikshme, me përjashtim të substancave me nivel mesatar ose të lartë radioaktiviteti, me kusht që kushtet për këtë transport të mos jenë më të rrepta se kushtet e përcaktuara në këto anekse.			nuk cenohet dhe vetëm për rastet e mëposhtme: a) transportin e sasive të vogla të mallrave të caktuara të rrezikshme, me përjashtim të substancave që kanë nivel mesatar ose të lartë radioaktiviteti, me kusht që kushtet për këtë transport të mos jenë më të rrepta se kushtet e përcaktuara në ADR ose RID;		caktuara të rrezikshme, me përjashtim të substancave me nivel mesatar ose të lartë radioaktiviteti, vetëm kur siguria e transportit nuk cenohet dhe kushtet nuk janë më të rrepta se ato të përcaktuara në ADR ose RID. Referimi ndaj ADN-së nuk pasqyrohet, pasi projektligji nuk lejon transportin e mallrave të rrezikshme në rrugë ujore të brendshme.
6 (2) (b)	(b) Me kusht që siguria të mos cenohet, shtetet anëtare mund të kërkojnë gjithashtu përjashtime nga aneksi I, seksioni I.1, aneksi II, seksioni II.1, dhe aneksi III, seksioni III.1, për transportin e mallrave të rrezikshme brenda territorit të tyre, në rastin e:	1.1	47.10	46.10 10. Përjashtimet me karakter të përgjithshëm nga ADR-ja ose RID-i, për transportin e mallrave të rrezikshme brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, mund të kërkojnë vetëm kur siguria e transportit nuk cenohet dhe vetëm për rastet e mëposhtme:	F	Projektligji parashikon bazën për kërkimin e përjashtimeve me karakter të përgjithshëm nga ADR-ja ose RID-i për transportin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, vetëm kur siguria e transportit nuk cenohet.
6 (2) (b) (i)	(i) transportit lokal në distanca të shkurtra; ose	1.1	47.10.b	b) transportin lokal në distanca të shkurtra;	F	Projektligji parashikon mundësinë për të kërkuar përjashtime me karakter të përgjithshëm për transportin lokal në distanca të shkurtra.
6 (2) (b) (ii)	(ii) transportit lokal hekurudhor në itinerare të posaçme të përcaktuara, që përbën pjesë të një procesi industrial të përcaktuar dhe kontrollohet ngushtë në kushte të përcaktuara qartë.	1.1	47.10.c	c) transportin lokal hekurudhor në itinerare të posaçme të përcaktuara, që përbëjnë pjesë të një procesi industrial të përcaktuar dhe kontrollohen ngushtë në kushte të përcaktuara qartë.	F	Projektligji pasqyron mundësinë për të kërkuar përjashtime me karakter të përgjithshëm për transportin lokal hekurudhor.
6 (2) (b), paragrafi i dytë	Komisioni shqyrton, rast pas rasti, nëse janë përmbushur kushtet e përcaktuara në nënparagrafët (a) dhe (b) dhe vendos, në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 9(2), nëse autorizon përjashtimin dhe e shton atë në listën e përjashtimeve kombëtare të	1.1	67.3	67.3. Pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ministria përgjegjëse për transportin i kërkon Komisionit Evropian autorizimin ose zgjatjen e autorizimit të përjashtimeve me karakter të përgjithshëm nga ADR-ja	N/A	Projektligji mbulon pjesën kombëtare të procedurës, duke parashikuar se ministria përgjegjëse për transportin i kërkon Komisionit Evropian autorizimin e përjashtimeve me karakter të përgjithshëm dhe se

	përcaktuara në aneksin I, seksioni I.3, aneksin II, seksioni II.3, ose aneksin III, seksioni III.3.			ose RID-i, në rastet e parashikuara në nenin 47, pika 10, të këtij ligji.		këto përjashtime zbatohen vetëm pas autorizimit nga Komisioni.
6 (3)	Përjashtimet sipas paragrafit 2 janë të vlefshme për një periudhë jo më të gjatë se gjashtë vjet nga data e autorizimit, periudhë e cila përcaktohet në vendimin e autorizimit. Për përjashtimet ekzistuese të përcaktuara në aneksin I, seksioni I.3, aneksin II, seksioni II.3, dhe aneksin III, seksioni III.3, data e autorizimit konsiderohet 30 qershor 2009. Përveç kur parashikohet ndryshe, përjashtimet janë të vlefshme për një periudhë gjashtëvjeçare.	1.1	67.4	67.4. Masat e propozuara sipas pikës 2, shkronja “c”, të këtij neni dhe përjashtimet me karakter të përgjithshëm sipas pikës 3 të këtij neni zbatohen vetëm pas autorizimit nga Komisioni Evropian dhe për afatin e përcaktuar në vendimin përkatës të autorizimit. Përjashtimet me karakter të përgjithshëm sipas pikës 3 të këtij neni nuk mund të autorizohen për një afat më të gjatë se gjashtë vjet nga data e autorizimit dhe zbatohen pa diskriminim.	F	Projektligji parashikon se përjashtimet me karakter të përgjithshëm zbatohen vetëm për periudhën e përcaktuar në vendimin përkatës të autorizimit dhe se kjo periudhë nuk mund të jetë më e gjatë se gjashtë vjet nga data e autorizimit.
6 (3), paragrafi i dytë	Përjashtimet zbatohen pa diskriminim.	1.1	67.4, fjalë e dytë	67.4. Përjashtimet me karakter të përgjithshëm sipas pikës 3 të këtij neni nuk mund të autorizohen për një afat më të gjatë se gjashtë vjet nga data e autorizimit dhe zbatohen pa diskriminim.	F	Projektligji parashikon shprehimisht se përjashtimet me karakter të përgjithshëm zbatohen pa diskriminim.
6 (4)	4. Nëse një shtet anëtar kërkon zgjatjen e një autorizimi për një përjashtim, Komisioni rishqyrton përjashtimin në fjalë.	1.1	67.3; 67.5	67.3. Pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ministria përgjegjëse për transportin i kërkon Komisionit Evropian autorizimin ose zgjatjen e autorizimit të përjashtimeve me karakter të përgjithshëm nga ADR-ja ose RID-i, në rastet e parashikuara në nenin 47, pika 10, të këtij ligji. 67.5. Kërkesa për zgjatjen e autorizimit të një përjashtimi me karakter të përgjithshëm sipas pikës 3 të këtij neni paraqitet nga ministria përgjegjëse për transportin pranë Komisionit Evropian përpara përfundimit të afatit të autorizimit në fuqi. Zgjatja zbatohet vetëm pas autorizimit nga Komisioni Evropian dhe për afatin e përcaktuar në vendimin përkatës.	N/A	Projektligji parashikon se ministria përgjegjëse për transportin i kërkon Komisionit Evropian zgjatjen e autorizimit të një përjashtimi me karakter të përgjithshëm dhe se kërkesa paraqitet përpara përfundimit të afatit të autorizimit në fuqi.

6 (4), paragrafi i dytë	Nëse nuk është miratuar ndonjë ndryshim i aneksit I, seksioni I.1, aneksit II, seksioni II.1, ose aneksit III, seksioni III.1, që prek objektin e përjashtimit, Komisioni, duke vepruar në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 9(2), rinovon autorizimin për një periudhë tjetër jo më të gjatë se gjashtë vjet nga data e autorizimit, periudhë e cila përcaktohet në vendimin e autorizimit.	1.1	67.5	67.5. Kërkesa për zgjatjen e autorizimit të një përjashtimi me karakter të përgjithshëm sipas pikës 3 të këtij neni paraqitet nga ministria përgjegjëse për transportin pranë Komisionit Evropian përpara përfundimit të afatit të autorizimit në fuqi. Zgjatja zbatohet vetëm pas autorizimit nga Komisioni Evropian dhe për afatin e përcaktuar në vendimin përkatës.	N/A	Projektligji mbulon pjesën kombëtare, duke parashikuar paraqitjen e kërkesës për zgjatjen e autorizimit dhe zbatimin e zgjatjes vetëm pas autorizimit nga Komisioni Evropian.
6 (4), paragrafi i tretë	Nëse është miratuar një ndryshim i aneksit I, seksioni I.1, aneksit II, seksioni II.1, ose aneksit III, seksioni III.1, që prek objektin e përjashtimit, Komisioni, duke vepruar në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 9(2), mund:	N/A		N/A	N/A	N/A
6 (4), paragrafi i tretë (a)	(a) ta shpallë përjashtimin të vjetruar dhe ta heqë nga aneksi përkatës;	N/A		N/A	N/A	N/A
6 (4), paragrafi i tretë (b)	(b) të kufizojë fushën e autorizimit dhe të ndryshojë përkatësisht aneksin përkatës;	N/A		N/A	N/A	N/A
6 (4), paragrafi i tretë (c)	(c) të rinovojë autorizimin për një periudhë tjetër jo më të gjatë se gjashtë vjet, periudhë e cila përcaktohet në vendimin e autorizimit.	N/A		N/A	N/A	N/A
6 (5)	5. Çdo shtet anëtar mund, në mënyrë përjashtimore dhe me kusht që siguria të mos cenohet, të lëshojë autorizime individuale për kryerjen brenda territorit të tij të operacioneve të transportit të mallrave të rrezikshme që ndalohen nga kjo direktivë, ose për kryerjen e këtyre operacioneve në kushte të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë direktivë, me kusht që këto operacione transporti të jenë të përcaktuara qartë dhe të kufizuara në kohë.	1.1	47.1; 47.7; 47.8; 47.9	1. Për raste të veçanta dhe të justifikuara, ministri përgjegjës për transportin mund të autorizojë kryerjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të një operacioni transporti të mallrave të rrezikshme që nuk lejohet sipas ADR-së ose RID-it, ose kryerjen e tij në kushte të ndryshme nga ato të ADR-së ose RID-it. 7. Autorizimi sipas këtij neni jepet vetëm kur operacioni i transportit është i përcaktuar qartë, i kufizuar në kohë dhe kur masat e propozuara sigurojnë që siguria e transportit të mos cenohet.	F	Projektligji transpozon mundësinë për lëshimin e autorizimeve individuale për raste të veçanta dhe të justifikuara, për operacione transporti që nuk lejohen sipas ADR-së ose RID-it ose që kryhen në kushte të ndryshme nga ato të përcaktuara në ADR ose RID. Autorizimi jepet vetëm kur operacioni është i përcaktuar qartë, i kufizuar në kohë dhe siguria e transportit nuk cenohet.

				8. Autorizimi përcakton subjektin e autorizuar, mallrat që transportohen, sasinë, mënyrën e transportit, itinerarin, afatin e vlefshmërisë, mjetin rrugor ose vagonin, ambalazhin, cisternën ose pajisjen që përdoret, kushtet e shoqërimit, njoftimit, mbikëqyrjes, ndërhyrjes emergjente dhe çdo masë tjetër të nevojshme sigurie. 9. Autorizimi sipas këtij neni nuk transferohet te një subjekt tjetër dhe nuk mund të përdoret për krijimin e një regjimi të përgjithshëm ose të përhershëm transporti në kushte të ndryshme nga ADR-ja ose RID-i.		Projektligji parashikon gjithashtu përmbajtjen e autorizimit, kufizimin e tij të subjekti i autorizuar dhe ndalimin e përdorimit të tij për krijimin e një regjimi të përgjithshëm ose të përhershëm transporti në kushte të ndryshme nga ADR-ja ose RID-i.
Neni 7 Dispozita kalimtare	1. Brenda territoreve të tyre përkatëse, shtetet anëtare mund të mbajnë në fuqi dispozitat e renditura në aneksin I, seksioni I.2, aneksin II, seksioni II.2, dhe aneksin III, seksioni III.2.	N/A	N/A	N/A	N/A	Projektligji nuk parashikon mbajtjen në fuqi të dispozitave kalimtare kombëtare.
7 (1)	Shtetet anëtare që mbajnë në fuqi këto dispozita informojnë Komisionin. Komisioni informon shtetet e tjera anëtare.	N/A	N/A	N/A	N/A	Si më sipër.
7 (2)	2. Pa cenuar nenin 1(3), shtetet anëtare mund të zgjedhin të mos zbatojnë dispozitat e aneksit III, seksioni III.1, deri më 30 qershor 2011. Në këtë rast, shteti anëtar përkatës, për rrugët ujore të brendshme, vazhdon të zbatojë dispozitat e direktivave 96/35/KE dhe 2000/18/KE, të zbatueshme më 30 qershor 2009.	N/A	N/A	N/A	N/A	Si më sipër.
Neni 8 Përshtatjet	1. Komisioni autorizohet të miratojë akte të deleguara, në përputhje me nenin 8a, për ndryshimin e anekseve me qëllim marrjen parasysh të ndryshimeve të ADR-së, RID-it dhe ADN-së, veçanërisht atyre që lidhen me përparimin shkencor dhe teknik, duke përfshirë përdorimin e teknologjive për gjurmimin dhe ndjekjen.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

	2. Komisioni u jep shteteve anëtare, sipas rastit, mbështetje financiare për përkthimin e ADR-së, RID-it dhe ADN-së dhe të ndryshimeve të tyre në gjuhën e tyre zyrtare.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Neni 8a Ushtrimi i delegimi t	1. Kompetenca për të miratuar akte të deleguara i jepet Komisionit, sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
8 (2)	2. Kompetenca për të miratuar akte të deleguara, e përmendur në nenin 8(1), i jepet Komisionit për një periudhë pesëvjeçare nga data 26 korrik 2019. Komisioni harton një raport për delegimin e kompetencës jo më vonë se nëntë muaj përpara përfundimit të periudhës pesëvjeçare. Delegimi i kompetencës zgjatet në heshtje për periudha me kohëzgjatje të njëjtë, përveçse kur Parlamenti Evropian ose Këshilli e kundërshton këtë zgjatje jo më vonë se tre muaj përpara përfundimit të çdo periudhe.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
8 (3)	3. Delegimi i kompetencës i përmendur në nenin 8(1) mund të revokohet në çdo kohë nga Parlamenti Evropian ose Këshilli. Vendimi për revokim i jep fund delegimit të kompetencës së përcaktuar në atë vendim. Ai hyn në fuqi ditën pas botimit të vendimit në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian ose në një datë të mëvonshme të përcaktuar në të. Ai nuk cenon vlefshmërinë e akteve të deleguara që janë tashmë në fuqi.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
8 (4)	4. Përpara miratimit të një akti të deleguar, Komisioni konsultohet me ekspertët e caktuar nga çdo shtet anëtar, në përputhje me parimet e përcaktuara në Marrëveshjen Ndërinstitucionale të 13 prillit 2016 për Legjislacion më të Mirë (1).	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

8 (5)	5. Sapo miraton një akt të deleguar, Komisioni ia njofton atë njëkohësisht Parlamentit Evropian dhe Këshillit.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
8 (6)	6. Një akt i deleguar i miratuar sipas nenit 8(1) hyn në fuqi vetëm nëse as Parlamenti Evropian dhe as Këshilli nuk kanë shprehur kundërshtim brenda një periudhe dymujore nga njoftimi i këtij akti Parlamentit Evropian dhe Këshillit, ose nëse, përpara përfundimit të kësaj periudhe, Parlamenti Evropian dhe Këshilli e kanë informuar Komisionin se nuk do të kundërshtojnë. Kjo periudhë zgjatet me dy muaj me nismën e Parlamentit Evropian ose të Këshillit.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Neni 9 Procedura e komitetit	1. Komisioni ndihmohet nga një komitet për transportin e mallrave të rrezikshme.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
9 (2)	2. Kur bëhet referim në këtë paragraf, zbatohen nenet 5 dhe 7 të Vendimit 1999/468/KE, duke marrë parasysh dispozitat e nenit 8 të tij.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
9 (2), paragrafi i dytë	Periudha e përmendur në nenin 5(6) të Vendimit 1999/468/KE caktohet në tre muaj.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Neni 10 Transpozimi	1. Shtetet anëtare miratojnë dhe vendosin në fuqi ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për të qenë në përputhje me këtë direktivë, jo më vonë se më 30 qershor 2009. Ato informojnë menjëherë Komisionin për këtë.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
10 (1), paragrafi i dytë	Kur shtetet anëtare miratojnë këto masa, ato përmbajnë një referim ndaj kësaj direktive ose shoqërohen me një referim të tillë në botimin e tyre zyrtar. Mënyra e bërjes së këtij referimi përcaktohet nga shtetet anëtare.	N/A	Shënimi i përafrimit në shënimin fundor të titullit të	Ky ligj është përafruar: Plotësisht me Direktivën 2008/68/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 24 shtator 2008, “Mbi transportin tokësor të mallrave të rrezikshme”, CELEX 32008L0068, botuar në Fletoren Zyrtare të	F	Projektligji përmban një referim të shprehur ndaj Direktivës 2008/68/KE në shënimin e përafrimit, ku deklarohet se ligji është përafruar plotësisht me këtë direktivë.

			projektligj	Bashkimit Evropian, seria L 260, datë 30.9.2008, fq. 13–59, siç është ndryshuar.		
10 (2)	2. Shtetet anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të së drejtës kombëtare që miratojnë në fushën e mbuluar nga kjo direktivë.	1.1	67.7	67.7. Pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ministria përgjegjëse për transportin i komunikon Komisionit Evropian tekstin e dispozitave kryesore të legjislacionit kombëtar të miratuara në fushën e rregulluar nga ky ligj.	F	Projektligji parashikon që, pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian, ministria përgjegjëse për transportin i komunikon Komisionit Evropian tekstin e dispozitave kryesore të legjislacionit kombëtar të miratuara në fushën e transportit të mallrave të rrezikshme.
Neni 11 Ndryshimi	Neni 6 i Direktivës 2006/87/KE shfuqizohet.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Neni 12 Shfuqizimet	1. Direktivat 94/55/KE, 96/49/KE, 96/35/KE dhe 2000/18/KE shfuqizohen nga data 30 qershor 2009. Certifikatat e lëshuara në zbatim të dispozitave të direktivave të shfuqizuara mbeten të vlefshme deri në datën e përfundimit të vlefshmërisë së tyre.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
12 (2)	1. 2. Vendimet 2005/263/KE dhe 2005/180/KE shfuqizohen.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Neni 13 Hyrja në fuqi	Kjo direktivë hyn në fuqi në ditën e njëzetë pas botimit të saj në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Neni 14 Të adresuari	Kjo direktivë u drejtohet shteteve anëtare.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
ANEKSI I.1	I.1. ADR Anekset A dhe B të ADR-së, të zbatueshme nga data 1 janar 2025, duke kuptuar se shprehja “palë kontraktuese” zëvendësohet, sipas rastit, me “shtet anëtar”.	1.1	5.1; 5.5; 5.6	5.1. Transporti i mallrave të rrezikshme me rrugë ose me hekurudhë lejohet vetëm kur kryhet në kushtet e përcaktuara përkatësisht në ADR, së bashku me anekset A dhe B të saj, ose në RID, si Shtojca C e Konventës për Transportin Ndërkombëtar Hekurudhor (COTIF), pa	F	Projektligji parashikon se transporti rrugor i mallrave të rrezikshme lejohet vetëm kur kryhet në kushtet e përcaktuara në ADR. Anekset teknike të ADR-së nuk riprodhohen në projektligj, por zbatohen

				cenuar rregullat e përgjithshme për hyrjen në treg dhe rregullat e përgjithshme të zbatueshme për transportin e mallrave. 5. Ndryshimet dhe përditësimet e ADR-së dhe RID-it ndiqen nga ministria përgjegjëse për transportin dhe zbatohen në Republikën e Shqipërisë në përputhje me procedurat e parashikuara në ADR dhe RID, si dhe me legjislacionin në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare. 6. Ministria përgjegjëse për transportin publikon në faqen e saj zyrtare informacionin për versionin e përditësuar të zbatueshëm të ADR-së dhe RID-it, lidhjet elektronike me tekstet autentike ose të konsoliduara dhe tekstin informues në gjuhën shqipe.		nëpërmjet referimit, sipas versionit të zbatueshëm.
ANEKSI I.2.1	I.2. Dispozita kalimtare shtesë 1. Shtetet anëtare mund të mbajnë në fuqi përjashtimet e miratuara në bazë të nenit 4 të Direktivës 94/55/KE deri më 31 dhjetor 2010 ose deri në ndryshimin e aneksit I, seksioni I.1, për të pasqyruar Rekomandimet e Kombeve të Bashkuara për Transportin e Mallrave të Rrezikshme, të përmendura në atë nen, nëse kjo ndodh më herët.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
ANEKSI I.2.2	2. Brenda territorit të tij, çdo shtet anëtar mund të autorizojë përdorimin e cisternave dhe mjeteve të ndërtuara përpara datës 1 janar 1997, të cilat nuk janë në përputhje me këtë direktivë, por janë ndërtuar në përputhje me kërkesat kombëtare në fuqi më 31 dhjetor 1996, me kusht që këto cisterna dhe mjete të mirëmbahen në nivelet e kërkuara të sigurisë. Cisternat dhe mjetet e ndërtuara më ose pas datës 1 janar 1997, të cilat nuk janë në përputhje me këtë direktivë, por janë ndërtuar	N/A	N/A	N/A	N/A	Projektligji nuk e përdor këtë mundësi dhe nuk parashikon një regjim të posaçëm kalimtar për cisternat ose mjetet e ndërtuara sipas kërkesave të mëparshme historike.

	në përputhje me kërkesat e Direktivës 94/55/KE në fuqi në datën e ndërtimit të tyre, mund të vazhdojnë të përdoren për transportin kombëtar.					
ANEKSI I.2.3	3. Brenda territorit të tij, çdo shtet anëtar ku temperatura e mjedisit është rregullisht më e ulët se –20 °C mund të vendosë standarde më të rrepta për temperaturën e përdorimit të materialeve të përdorura për ambalazhet plastike, cisternat dhe pajisjet e tyre, të destinuara për transportin kombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme, derisa dispozitat për temperaturat e përshtatshme të referencës për zonat e caktuara klimatike të përfshihen në aneksin I, seksioni I.1, të kësaj direktive.	N/A	N/A	N/A	N/A	Kushtet e posaçme klimatike të përmendura në këtë dispozitë, përkatësisht temperaturat nën – 20 °C, nuk janë të rëndësishme për kushtet klimatike të Shqipërisë.
ANEKSI I.2.4	4. Brenda territorit të tij, çdo shtet anëtar mund të mbajë në fuqi dispozita kombëtare të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë direktivë për temperaturën e referencës për transportin e gazeve të lëngëzuara ose përzierjeve të gazeve të lëngëzuara, derisa dispozitat për temperaturat e përshtatshme të referencës për zonat klimatike të përcaktuara të përfshihen në standardet evropiane dhe të referohen në aneksin I, seksioni I.1, të kësaj direktive.	N/A	N/A	N/A	N/A	Projektligji nuk parashikon mbajtjen në fuqi të dispozitave të posaçme kombëtare për temperaturën e referencës për transportin e gazeve të lëngëzuara ose përzierjeve të gazeve të lëngëzuara. Rregullat teknike për këtë transport zbatohen sipas ADR-së.
ANEKSI I.2.5	5. Çdo shtet anëtar mund, për operacionet e transportit të kryera me mjete të regjistruara brenda territorit të tij, të mbajë në fuqi dispozitat e legjislationit të tij kombëtar që ishin në fuqi më 31 dhjetor 1996, lidhur me paraqitjen ose vendosjen e një kodi veprimi emergjent ose karte rreziku në vend të numrit të identifikimit të rrezikut të përcaktuar në aneksin I, seksioni I.1, të kësaj direktive.	N/A	N/A	N/A	N/A	Projektligji nuk parashikon mbajtjen në fuqi të dispozitave historike kombëtare për paraqitjen ose vendosjen e një kodi veprimi emergjent ose karte rreziku në vend të numrit të identifikimit të rrezikut. Kërkesat për shënimin, etiketimin dhe identifikimin e rrezikut zbatohen sipas ADR-së.

ANEKSI I.2.6	6. Shtetet anëtare mund të mbajnë në fuqi kufizimet kombëtare për transportin e substancave që përmbajnë dioksina dhe furane, të zbatueshme më 31 dhjetor 1996.	N/A	N/A	N/A	N/A	Projektligji nuk parashikon mbajtjen në fuqi të kufizimeve historike kombëtare për transportin e substancave që përmbajnë dioksina dhe furane. Çdo kufizim për këto substanca zbatohet sipas ADR-së dhe, kur është rasti, sipas legjislacionit mjedisor ose legjislacionit tjetër sektorial.
ANEKSI I.3	I.3. Përjashtimet kombëtare Përjashtimet për shtetet anëtare për transportin e mallrave të rrezikshme brenda territorit të tyre, në bazë të nenit 6(2) të Direktivës 2008/68/KE.	N/A	N/A	N/A	N/A	Projektligji nuk përmban listë të përjashtimeve kombëtare sipas aneksit I, seksioni I.3. Çdo përjashtim me karakter të përgjithshëm nga ADR-ja mund të kërkohet sipas nenit 47 të projektligjit dhe, pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian, sipas nenit 67 për komunikimin me Komisionin Evropian.
ANEKSI II.1	TRANSPORTI HEKURUDHOR II.1. RID Aneksi i RID-it, i zbatueshëm nga data 1 janar 2025, duke kuptuar se shprehja “shtet kontraktues i RID-it” zëvendësohet, sipas rastit, me “shtet anëtar”.	1.1	5.1; 5.5; 5.6	5.1 Transporti i mallrave të rrezikshme me rrugë ose me hekurudhë lejohet vetëm kur kryhet në kushtet e përcaktuara përkatësisht në ADR, së bashku me anekset A dhe B të saj, ose në RID, si Shtojca C e Konventës për Transportin Ndërkombëtar Hekurudhor (COTIF), pa cenuar rregullat e përgjithshme për hyrjen në treg dhe rregullat e përgjithshme të zbatueshme për transportin e mallrave. 5.5 Ndryshimet dhe përditësimet e ADR-së dhe RID-it ndiqen nga ministria përgjegjëse për transportin dhe zbatohen në Republikën e Shqipërisë në përputhje me procedurat e parashikuara në ADR dhe RID, si dhe me legjislacionin në fuqi për	F	Projektligji parashikon se transporti hekurudhor i mallrave të rrezikshme lejohet vetëm kur kryhet në kushtet e përcaktuara në RID. Rregullat teknike të RID-it nuk riprodhohen në projektligj, por zbatohen nëpërmjet referimit, sipas versionit të zbatueshëm.

				marrëveshjet ndërkombëtare. 5.6. Ministria përgjegjëse për transportin publikon në faqen e saj zyrtare informacionin për versionin e përditësuar të zbatueshëm të ADR-së dhe RID-it, lidhjet elektronike me tekstet autentike ose të konsoliduara dhe tekstin informues në gjuhën shqipe.		
ANEKSI II.2.1	II.2. Dispozita kalimtare shitesë 1. Shtetet anëtare mund të mbajnë në fuqi përjashtimet e miratuara në bazë të nenit 4 të Direktivës 96/49/KE deri më 31 dhjetor 2010 ose deri në ndryshimin e aneksit II, seksioni II.1, për të pasqyruar Rekomandimet e Kombeve të Bashkuara për Transportin e Mallrave të Rrezikshme, të përmendura në atë nen, nëse kjo ndodh më herët.	N/A	N/A	N/A	N/A	Projektligji nuk parashikon mbajtjen në fuqi të përjashtimeve historike të miratuara.
ANEKSI II.2.2	2. Brenda territorit të tij, çdo shtet anëtar mund të autorizojë përdorimin e vagonëve dhe vagonëve-cisternë me gjerësi shine 1 520/1 524 mm, të ndërtuar përpara datës 1 korrik 2005, të cilët nuk janë në përputhje me këtë direktivë, por janë ndërtuar në përputhje me aneksin II të SMGS-së ose me dispozitat kombëtare të atij shteti anëtar në fuqi më 30 qershor 2005, me kusht që këta vagonë të mirëmbahen në nivelet e kërkuara të sigurisë.	N/A	N/A	N/A	N/A	Dispozita nuk është e zbatueshme për Shqipërinë, pasi lidhet me sisteme hekurudhore me gjerësi shine 1 520/1 524 mm, të cilat nuk ekzistojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
ANEKSI II.2.3	3. Brenda territorit të tij, çdo shtet anëtar mund të autorizojë përdorimin e cisternave dhe vagonëve të ndërtuar përpara datës 1 janar 1997, të cilët nuk janë në përputhje me këtë direktivë, por janë ndërtuar në përputhje me kërkesat kombëtare në fuqi më 31 dhjetor 1996, me kusht që këto cisterna dhe vagonë të mirëmbahen në nivelet e kërkuara të sigurisë. Cisternat dhe vagonët e ndërtuar më ose pas datës 1 janar 1997, të cilët nuk janë në	N/A	N/A	N/A	N/A	Projektligji nuk parashikon regjim kalimtar për përdorimin e cisternave ose vagonëve të ndërtuar sipas kërkesave historike kombëtare.

	përputhje me këtë direktivë, por janë ndërtuar në përputhje me kërkesat e Direktivës 96/49/KE të zbatueshme në datën e ndërtimit të tyre, mund të vazhdojnë të përdoren për transportin kombëtar.					
ANEKSI II.2.4	4. Brenda territorit të tij, çdo shtet anëtar ku temperatura e mjedisit është rregullisht më e ulët se -20 °C mund të vendosë standarde më të rrepta për temperaturën e përdorimit të materialeve të përdorura për ambalazhet plastike, cisternat dhe pajisjet e tyre, të destinuara për transportin kombëtar hekurudhor të mallrave të rrezikshme, derisa dispozitat për temperaturat e përshtatshme të referencës për zonat e caktuara klimatike të përfshihen në aneksin II, seksioni II.1, të kësaj direktive.	N/A	N/A	N/A	N/A	Projektligji nuk parashikon standarde kombëtare më të rrepta për temperaturën e përdorimit të materialeve të përdorura për ambalazhet plastike, cisternat ose pajisjet e tyre për transportin hekurudhor të mallrave të rrezikshme.
ANEKSI II.2.5	5. Brenda territorit të tij, çdo shtet anëtar mund të mbajë në fuqi dispozita kombëtare të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë direktivë për temperaturën e referencës për transportin e gazeve të lëngëzuara ose përzierjeve të gazeve të lëngëzuara, derisa dispozitat për temperaturat e përshtatshme të referencës për zonat klimatike të përcaktuara të përfshihen në standardet evropiane dhe të referohen në aneksin II, seksioni II.1, të kësaj direktive.	N/A	N/A	N/A	N/A	Projektligji nuk parashikon mbajtjen në fuqi të dispozitave të posaçme kombëtare për temperaturën e referencës për transportin hekurudhor të gazeve të lëngëzuara ose përzierjeve të gazeve të lëngëzuara.
ANEKSI II.2.6	6. Çdo shtet anëtar mund, për operacionet e transportit të kryera me vagonë të regjistruar brenda territorit të tij, të mbajë në fuqi dispozitat e legjislationit të tij kombëtar që ishin në fuqi më 31 dhjetor 1996, lidhur me paraqitjen ose vendosjen e një kodi veprimi emergjent ose karte rreziku në vend të numrit të identifikimit të rrezikut të parashikuar në aneksin II, seksioni II.1, të kësaj direktive.	N/A	N/A	N/A	N/A	Projektligji nuk parashikon mbajtjen në fuqi të dispozitave historike kombëtare për paraqitjen ose vendosjen e një kodi veprimi emergjent ose karte rreziku në vend të numrit të identifikimit të rrezikut.

ANEKSI II.2.7	7. Për transportin nëpërmjet Tunelit të La Manshit, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar mund të vendosin dispozita më të rrepta se ato të përcaktuara në këtë direktivë.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
ANEKSI II.2.8	8. Një shtet anëtar mund të mbajë në fuqi dhe të miratojë dispozita për territorin e tij për transportin hekurudhor të mallrave të rrezikshme nga dhe drejt palëve kontraktuese të OSJD-së. Nëpërmjet masave dhe detyrimeve të përshtatshme, shtetet anëtare përkatëse garantojnë ruajtjen e një niveli sigurie të barasvlershëm me atë të parashikuar në aneksin II, seksioni II.1. Komisioni informohet për këto dispozita dhe informon përkatësisht shtetet e tjera anëtare. Brenda 10 vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj direktive, Komisioni vlerëson pasojat e dispozitave të përmendura në këtë paragraf. Nëse është e nevojshme, Komisioni paraqet propozime të përshtatshme së bashku me një raport.	N/A	N/A	N/A	N/A	Dispozita nuk është e zbatueshme për Shqipërinë në këtë fazë. Megjithatë Shqipëria është palë në OSJD, kjo dispozitë rregullon një mekanizëm të posaçëm të zbatueshëm për shtetet anëtare të BE-së në marrëdhëniet e tyre me palët kontraktuese të OSJD-së.
ANEKSI II.2.9	9. Shtetet anëtare mund të mbajnë në fuqi kufizimet kombëtare për transportin e substancave që përmbajnë dioksina dhe furane, të zbatueshme më 31 dhjetor 1996.	N/A	N/A	N/A	N/A	Projektligji nuk parashikon mbajtjen në fuqi të kufizimeve historike kombëtare për transportin e substancave që përmbajnë dioksina dhe furane.
ANEKSI II.3	II.3. Përfshirjet kombëtare Përfshirjet për shtetet anëtare për transportin e mallrave të rrezikshme brenda territorit të tyre, në bazë të nenit 6(2) të Direktivës 2008/68/KE.	N/A	N/A	N/A	N/A	Projektligji nuk përmban listë të përfshirjeve kombëtare sipas aneksit II, seksioni II.3.
ANEKSI III TRANSPORTI NË RRUGË UJORE	III.1. ADN Rregulloret që i bashkëlidhen ADN-së, të zbatueshme nga data 1 janar 2025, si dhe neni 3, shkronjat (f) dhe (h), dhe neni 8(1) dhe (3) i ADN-së, duke kuptuar se shprehja “palë	N/A	N/A	N/A	N/A	Transporti i mallrave të rrezikshme në rrugë ujore të brendshme nuk lejohet sipas projektligjit.

TË BREND SHME	kontraktuese” zëvendësohet, sipas rastit, me “shtet anëtar”.					
ANEKSI III.2.1	III.2. Dispozita kalimtare shtesë 1. Shtetet anëtare mund të mbajnë në fuqi kufizimet për transportin e substancave që përmbajnë dioksina dhe furane, të zbatueshme më 30 qershor 2009.	N/A	N/A	N/A	N/A	Si më sipër.
ANEKSI III.2.2	2. Certifikatat, në përputhje me aneksin III, seksioni III.1 (8.1), të lëshuara përpara ose gjatë periudhës kalimtare të përmendur në nenin 7(2), janë të vlefshme deri më 30 qershor 2016, përveçse kur në vetë certifikatën përcaktohet një periudhë më e shkurtër vlefshmërie.	N/A	N/A	N/A	N/A	Si më sipër.
ANEKSI III.3	III.3. Përjashtimet kombëtare Përjashtimet për shtetet anëtare për transportin e mallrave të rrezikshme brenda territorit të tyre, në bazë të nenit 6(2) të Direktivës 2008/68/KE.	N/A	N/A	N/A	N/A	Si më sipër.